
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
B2 INVEST SHPK**

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"B2 INVEST" Sh.p.k.**

Sot, në Tiranë, më datë 31.10.2022 ortakët e shoqërisë nënshkruajnë këtë Akt Themelimi dhe themelojnë sipas legjislacionit shqiptar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Gjithashtu, ortakët kanë vendosur të nënshkruajë edhe Statutin e kësaj shoqërie, aktiviteti dhe organizimi i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KREU I
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1
EMRI I SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**B2 INVEST**" Sh.p.k., më poshtë e quajtur "**Shoqëria**".

**NENI 2
SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, Shqipëri, ne adresën: Rruga "Loni Ligori", Pallati Miketa 2000, kat 1, Kashar, Tirane, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter ose të themelojë e myllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat te pacaktuar.

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e aktivitetit që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti mund të kryejë në territorin e Republikës së Shqipërisë por edhe jashtë saj:



- (i) Kryerja e aktivitetit tregtar: Sherbim konsulence ne fushen e pronave te paluajtshme, studime tregu, konsulence menaxhimi, sherbim menaxhimi.
- 4.2 Për të realizuar objektin te saj, Shoqëria, me vendim te Asamblesë së Përgjithshme mund te realizoje drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë çdo lloj pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja.
- 4.3 Shoqëria, me vendim te organit administrativ, dhe me qellim arritjen e objektit te saj, mund te lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryeje çdo veprim tregtar që organi administrativ do ta konsideroje të nevojshëm.

KREU II
KAPITALI, CERTIFIKATAT E KUOTAVE DHE ZMADHIMI DHE
ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 5
KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë B2 INVEST Sh.p.k. është i barabartë me 1000 (një mijë) Lekë, ne 1 (një) kuote. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet dhe paguhet nga ortaku sipas kontributeve të mëposhtme:
- Z. Gerald Bilbili, shtetas shqiptar, lindur në Corovode, Skrapar, Shqiperi, me 21.06.1986, pajisur me karte identiteti nr. I60621091B, me banim ne adresen Rr. Loni Ligori, M2000, kat 2 Tirane, Shqiperi, zotëron 1 (një) kuote të kapitalit, të barabartë me 100% të kapitalit të Shoqërisë;

NENI 6
ÇERTIFIKATAT E KUOTAVE

- 6.1 Ortaku ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me ligjin. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në çertifikatën e kuotës. Çertifikata nuk gjëzon cilësinë e letrës me vlerë.

NENI 7
KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI
OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT TË ORTAKUT



- 7.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gjëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjera.
- 7.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedh të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 7.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gjëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKR.

NENI 8 **ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.12 të këtij Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do ti komunikohet me shkrim ortakeve te cilët u thirren por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kenë te drejte te nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne përpjesëtim te drejte me kuotat që zotërojnë ne Shoqëri.
- 8.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nënshkrimit, kapitali që nuk është nënshkruar mund te nënshkruhet nga ortaket e tjere. Ne këtë rast, këta ortake mund te ushtrojnë te drejtën për nënshkrimin e kapitalit, ne përpjesëtim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqëri.

NENI 9 **ZVOGELIMI I KAPITALIT**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 10.12 të këtij Statuti. Ne çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogëlohet nen kufirin e përcaktuar me ligj.



- 9.2 Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

KREU III
ORGANET E SHOQËRISË

NENI 10
ASAMBLEJA E ORTAKËVE

- 10.1 Asambleja e Ortakëve është organi vendimmarres i Shoqërisë. Asambleja e Ortakëve vendos mbi te gjitha çështjet per te cilat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, ky Statut dhe/ose çdo Marrëveshje Ortakesh.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë për të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zoteron ne Shoqëri.
- 10.3 Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me autorizim me shkrim.
- 10.4 Ortaket nuk mund te delegojnë te drejtat e votës për pjese te kuotës, nëse votojnë personalisht për pjesën e mbetur te kuotës.
- 10.5 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mund të mbahet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (në vijim "Ligji"). Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve. Mbledhja e Asamblese se Ortakëve do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet si Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali në librin përkatës.
- 10.6 Asambleja e Ortakëve mund te thirret nga Administratori/ët ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes se Asamblesë se Ortakëve duhet te behet nëpërmjet njoftimit me letër rekomande apo nepermjet postes elektronike te njoftuar Shoqerise, te paktën 7 ditë përpara datës se caktuar për mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën në të cilën do të mblidhet Asambleja e Ortakëve, si dhe çështjet e rendit të ditës.



- 10.7 Asambleja e Ortakëve do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitetet, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakort per çeshtjet e rendit te dites.
- 10.8 Mbledhjet e Asamblesë se Ortakëve kryesohej nga Administratori/et. Asambleja e Ortakëve cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave te pranishëm.
- 10.9 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat e tyre.
- 10.10 Asambleja e Ortakëve mblidhet te paktën një here në vit, brenda 6 muajve nga mbyllja e vtitit finanziar.
- 10.11 Asambleja e Ortakëve, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicë te zakonshme, merr vendime te vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortaket me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, qe zoterojnë me shume se 30% të kapitalit të Shoqërisë, përvèç rasteve te parashikuara me poshte ne nenin 10.12. Ne rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Ortakëve thirret ne një mbledhje te dyte brenda 30 ditësh nga mbledhja e pare.
- 10.12 Asambleja e Ortakëve vendos me votat pro të te pakten $\frac{3}{4}$ të ortakeve pjesëmarrës që zoterojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë per ndryshimin e këtij statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

NENI 11 **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 11.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/ët i cili/të cilët zgjidhen nga Asambleja e Ortakëve për një periudhë prej 5 vjetësh. Administratori/ët mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohe nga Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Administratori/t zoteron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përvèç atyre qe ligji apo statuti ia rezervon Asamblesë se Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 11.3 Administratori/ët veprojnë në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Ortakëve. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera ne administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë. Administratori mbajnë përgjegjësi direkte për aktet dhe veprimtarinë e personave të tretë të deleguar për administrimin e Shoqërisë.



- 11.4 Administratori/ët do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interes së Shoqërisë. Në rast konflikt interesit, Administratori përkatës do të njoftojë menjëherë ortaket si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me shkakun e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Ortakëve.
- 11.5 Administratori i parë i Shoqërisë, te cilit i jepen tagra te plota dhe te pakufizuara ne administrimin e Shoqerise, emerohet:
- Z. Gerald Bilbili, shtetas shqiptar, lindur në Corovode, Skrapar, Shqiperi, me 21.06.1986, pajisur me karte identiteti nr.I60621091B, me banim ne adresen Rr. Loni Ligori, M2000, kati 2 Tirane, Shqiperi.

**NENI 12
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATOREVE**

- 12.1 Asambleja e Ortakeve përcakton shpërblimin e Administratorit/ve te Shoqërisë.

**NENI 13
SHKARKIMI I ADMINISTRATORIT/VE**

- 13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
- (a) personi nuk gjëzon cilësinë e Administrator sipas parashikimeve të ligjit;
 - (b) personi shkarkohet nga ky pozicion Asambleja e Ortakëve;
 - (c) personi qe ka shkelur dispozitat e ketij Statuti dhe te Ligjt ne lidhje me detyrimet e tij kundrejt Shoqerise;
 - (d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë; ose
 - (e) ka munguar pa arsy për më shumë se 6 muaj radhazi në detyrë dhe Asambleja e Ortakëve vendos ta shkarkojë nga detyra.

**KREU IV
KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË,
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI**

**NENI 14
KONTROLLI FINANCIAR**

- 14.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Kontabilist te Miratuar, Eksperte Kontabël të Autorizuar, apo nga persona te tjere sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Ortakeve do të emëroje një apo më shume nga personat e mesiperm në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në baze të ligjit.



**NENI 15
VITI FINANCIAR**

- 15.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 16
BILANCI VJETOR**

- 16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratoreve dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakëve. Administratori i paraqet per miratim Asamblesë se Ortakëve reportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogarite vjetore.
- 16.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin financiar duhet te aprovojen brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

**NENI 17
DIVIDENDI**

- 17.1 Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të ligjit ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Ortakëve mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 17.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendifit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- 17.3 Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të jetë interes-bartëse ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

**NENI 18
KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN E SHOQERISE**



- 18.1 Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Ortakëve me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpérndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KREU V

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

NENI 19

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 19.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqërisë do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 20

LIGJI I ZBATUESHËM

- 20.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje te plete me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar ne këtë Statut, do te aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushën e shoqërive tregtare.

NENI 21

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 21.1 Mosmarrëveshjet qe mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakeve te tjerë dhe/ose Shoqërisë, qe kane për objekt te drejta te lidhura me Shoqërinë, do te zgjidhen miqësisht ndërmjet paleve te interesuar. Ne rast te kundërt, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

NENI 22

GJUHA

- 22.1 Ky statut hartohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

Z. Gerald Bilbili

Gerald Bilbili
Burk